

## U MBAJT SEMINARI VI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE

Si çdo vit që nga 1974 edhe sivjet u mbajt Seminari (VI) Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, duke filluar prej 20 gushtit deri më 7 shtator. Ky seminar u mbajt në Prishtinë.

S'ka dyshim se ky institucion tashmë ka marrë përmasa të gjera me karakter botëror dhe është bërë një formë e rëndësishme për afirmimin e gjuhës, të letërsisë, të historisë, të kulturës si dhe të qytetërimit shqiptar në përgjithësi në botën e jashtme. Ai është njëherit një urë për të lidhur ngusht veprimtarinë e albanologëve të vendit tonë me atë të albanologëve të huaj nga mbarë bota. Në të gjithnjë e më shumë po vjen në shprehje bashkëpunimi i ngushtë mes albanologëve të shquar ku po nxirren në shesh të dhëna interesante dhe të dobishme nga shkenca e albanologjisë.

Seminari i këtij viti ishte më i begatshmi deri tani dhe me numrin më të madh të pjesëmarrësve që ka pasur ndonjëherë më parë. Morën pjesë 105 albanologë dhe të interesuar të tjerë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare nga tri kontinente të botës: nga Evropa, Azia dhe Amerika. Më së shumeti kishte arbëreshë nga Italia (31), pastaj nga Siria (16), nga 7 vetë nga BRSS, nga Bullgaria dhe nga Polonia, 4 vetë nga RD e Gjermanisë, 3 vetë nga Turqia dhe po aq nga Rumunia, si dhe nga një apo dy nga Kanadaja, Britania e Madhe, Belgjika, dhe 5 vetë nga Jugosllavia.

Gjatë 20 ditëve të seminarit u mbajtën nja 13 ligjërata nga lëmenj të ndryshëm, si: gjuhësi, letërsi, art, zhvillimi shoqëroro-politik dhe ekonomik i Kosovës, etj. Këto ligjërata u mbajtën nga profesorët e Fakultetit Filozofik dhe nga punonjësit e Institutit Albanologjik të Prishtinës. Në Seminar ligjëruan: akademiku Idriz Ajeti. Mbi *studimet etimologjike të gjuhës shqipe*; akademiku Rexhep Qosja — *Poetika e figuracionit të vargut romantik*; prof. dr. Shefqet Pllana — *Anegdodat popullore shqiptare*; prof. dr. Fehmi Agani — *Pozita e Kosovës në federalizmin jugosllav dhe zhvillimi i saj politiko-shoqëror*; Hasan Mekuli — *Zhvillimi i teatrit shqiptar*; Exhlale Dobruna-Salihu — *Llojet e elementeve sepulkrare tek ilirët*; Gani Luboteni — *Romani historik shqiptar*; mr. Isak Shema — *Letërsia shqipe e Luftës Nacionalçlirimtare*; Nebih Muriqi — *Zhvillimi i pikurës shqiptare*; Rexhep Ismajli — *Shqipja letrare e shekujve XVI e XVII*; dhe Isa Bajcinca — *Disa çështje të fjalëformimit të gjuhës letrare shqipe*.

Risi e seminarit të sivjemë ishte puna e kursit të letërsisë, në kuadër të të cilit u mbajtën nja shtatë ligjërata, si ajo mbi *Tiparet dhe përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së Rilindjes* (mr. Enver Gjerqeku) dhe *Karakterit dhe vlera e poezisë së Rilindjes* (Latif Berisha), pastaj *Poezia e sotme shqiptare* (dr. Ali Aliu dhe mr. Agim Vinca); *Poezia e sotme shqiptare* (mr. Isak Shema); *Letërsia popullore shqiptare* (prof. dr. Shefqet Pllana).

Gjatë këtij seminari punuan tri kurse të gjuhës shqipe: i ulëti, i mesmi dhe i larti. Rëndësi të veçantë ka të theksohet se puna me kursin e tretë sivjet u organizua në një mënyrë shumë të dobishme dhe interesante për të gjithë pjesëmarrësit. Në këtë kurs zhvilloheshin biseda shumë serioze mbi gjuhësinë shqiptare, tema këto mbi të cilat folën si gjuhëtarët — albanologët e vendit ashtu edhe ata të huajt. Ndër të tjerë këtu referuan: prof. dr. Latif Mulaku me temën *Disa probleme të morfologjisë së shqipes*; prof. dr. Besim Bokshi — *Mbi pozitën e njëjës shquese në gjuhët ballkanike* Rexhep Ismajli — *Problemi i origjinës së gjuhës shqipe*, kurse nga të huajt zhvilluan biseda dr. Oda Buholc nga RD e Gjermanisë, mbi temën *Leksiku shoqëror në veprat e L. Gurakuqit dhe të M. Gramenos*; dr. Vilfried Fidler, poashtu nga RD e Gjermanisë, foli mbi temën *Terminologjia politiko-shoqërore në disa kalendarë të botuar rreth vitit 1900*; dr. Leshek

Bednarçuk nga Polonia foli mbi *Lidhjet e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve paleobalkanike*; dr. Irina Voronina nga BRSS, mbi *Togfjalëshat si objekt studimi të sintaksës së gjuhës shqipe*, etj.

Ky seminar gjatë dy ditëve të fundit organizoi një sesion shkencor me temën bosht-Mbi kontributin e albanologëve të huaj në gjuhën shqipe, gjegjësisht në letërsinë shqiptare. U lexuan gjithsej 25 kumtesa, të cilat i paraqitën bashkëpunëtorë shkencorë e profesorë universitarë nga vendi, si dhe bashkëpunëtorë shkencorë — albanologë — nga vendet e ndryshme, të cilët njëherit ishin edhe pjesëmarrës të këtij seminari.

Duhet cekur se pos këtyre aktiviteteve, gjatë këtij seminari u organizuan edhe shumë takime e vizita nëpër institucione të ndryshme kulturore, arsimore dhe shkencore në Prishtinë. Kështu, pjesëmarrësit e seminarit vizituan Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, ku u njohën nga rektori, akademiku Gazmend Zajmi, mbi zhvillimin e këtij institucioni më të lartë akademik në Kosovë dhe mbi disa cilësi tipike për këtë universitet që e dallon nga universitetet e tjera të vendit dhe të botës, si çështja e mësimdhënies në dy gjuhë etj. Me rastin e vizitës në Insitutin Albanologjik, drejtori, akademik Rexhep Qosja, i njohti me disa çështje interesante të rritës së këtij instituti të rëndësishëm për qytetërimin shqiptar. Seminaristët e vizituan edhe Pallatin e Shtypit, ku i priti drejtori i përgjithshëm i „Rilindjes”, Rexhep Zogaj, i cili u foli për rolin e kësaj ndërmarrjeje të madhe dhe të vetme në Krahinë si dhe për zhvillimin e saj të mëtejme. Pjesëmarrësit e seminarit patën edhe disa pritje të tjera dhe bënë disa vizita të tjera.

Për pjesëmarrësit e këtij seminari Teatri Popullor Krahinor organizoi dy programe — *Migjeni* në skenën Sofra dhe pjesën teatrale *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, dramatizuar nga romani i Ismail Kadaresë.

Edhe Kosova Filmi shfaqti filmin „Kur pranvera vonohet”, për herë të parë, për pjesëmarrësit e këtij seminari. Si nga pjesët teatrale ashtu edhe nga filmi seminaristët mbetën shumë të kënaqur.

Drejtori i Seminarit së bashku me Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës organizuan një mbërmje poezie të përbashkët me poetët e Kosovës dhe pjesëmarrësit e seminarit. Atë natë lexuan poezitë e veta: Enver Gjerqeku, Fahredin Gunga, Rrahman Dedaj, Musa Ramadani, Ali Podrimja, Eqrem Basha, Agim Vinca, etj., ndërsa nga seminaristët, pos të tjerëve lexuan poezitë e tyre Karmell Kandreva, Luigji de Rosa, Kate Cukaro, Francisko Fuska nga Italia dhe Abdylatif Arnauti nga Siria.

Të gjitha këto takime të seminaristëve me përfaqësues të institucioneve të ndryshme kulturore, shkencore dhe arsimore të Kosovës dhe dy ekskursionet e bëra nëpër Krahinë u bënë të mundshme atyre që të njihen edhe më mirë me realitetin tonë socialist vetëqeverisës dhe me afirmimin e tij, rezultatet e ndryshme që ka arritur vendi ynë dhe populli shqiptar në përgjithësi etj.

Rezultatet e këtij seminari është vështirë të paraqiten me të dhëna konkrete, por ato janë të dukshme në shumë pikëpamje. Pos përhapjes së shkencës së albanologjisë në gjithë botën, si rezultat i seminarit priten edhe shumë botime, përkthime e shkrime të ndryshme që do të bëhen nga ana e pjesëmarrësve pasi të kthehen nëpër vendet e tyre. Janë bërë gjer tani mjaft studime albanologjike dhe janë botuar nëpër vende të ndryshme të botës, e të cilat e kanë nismën mu nga ky seminar. Pra, ai e ka arsyetuar dhe e ka shpërblyer veten me rezultatet e deritashme. Ndërsa në të ardhmen pritet edhe më shumë.